ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E ISTOGUT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**633-24-11478-5-2-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **DISLOKIMI I ELEMENTEVE TE LINJAVE TE TENSIONIT TE MESEM DHE TE ULET.(633-024-090-521)projekt 2vjeqar.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Risamont SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Brahim Ademi, Bregu i Diellit

(Adresa)

Prishtinë ***10 000***

(Vendi) *(Kodi postar)*

+38349393528

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Riad Rexhepi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

risamont@gmail.com
(Adresa elektronike)

20.11.2024
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K. RISAMONT PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 31.10.2024 Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 21.11.2024 Kerkesa per rishqyrtim eshte dorezuar me date: 14.11.2024 Pergjegja ne Kerkesen per Rishqyrtim eshte pranuar me date: Nuka ka pergjegje fare

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 6 i LPP-së** **Neni 7 i LPP-së** **Neni 51 i LPP-së** **Neni 53 i LPP-së** **Neni 65 i LPP-së** **Neni 69 i LPP-së** **Neni 70 i LPP-së** **Neni 72 i LPP-së** ***Neni 53 te LPP, respektivisht Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik- Neni 24 Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik, respektivisht*** ***Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik, respektivisht*** ***Neni 60 Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore, respektivisht Neni 63 Vendimi i Autoritetit Kontraktues nga RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK*** ***Neni 25 Kriteret e përzgjedhjes***

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pas analizes se dokumenteve te tenderit ateher kemi gjetur keto shkelje te cilat po i rangojme hap pas hapit:

Sipas kerkesave te pershkruara ne FDT, ateher:

- *Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale*
  Kapaciteti teknik dhe professional:
  Kerkesa:
  2. Stafi profesional
  - Menaxheri i kotratës duhet të jetë inxhinieri Inxhinier(master) elektrikes-drejtimi elektronike me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.I certifikuar si auditor I energjise ne ndertesa dhe ndricim public sipas standardit DIN EN 16247.
  -Një (1) Inxhinier apo master i ndërtimtarise drejtimi konstruktiv me pervoje pune minimum 5 vjeqare.
  -Nje(1) inxhinier(master) I makinerise drejtimi termoenergjetike me pervoje pune 5 vite.I certifikuar per auditimin e energjise ne ndertesa sipas standardit DIN EN 16247
  -Nje (1) inxhinier I makinerise I certifikuar me IWS (International Welding Specialist) nga IIW (International Welding Institute) dhe I certifikuar si ekspert per siguri dhe shendet ne pune nga Ministria e Punes dhe Mireqenies Sociale. -Nje (1) person pergjegjes per siguri dhe shendet ne pune, te jete Inxh ose master i menaxhimit te emergjencave, i certifikuar per shendet dhe siguri ne pune nga MPMS..

  Deshmite:
  Dëshmia 2. Për Menaxherin e projektit (inxhinieri) duhet te kete Diplomen-kopje e noterizuar , me kontrate apo parakontrata ne emer të projektit(në rast të angazhimit për këtë projekt, kontrata e menaxherit me ofertuesin duhet të jetë e noterizuar dhe e nënshkruar nga të dy palet në prezencë të noterit).- vendim për Projektmenagjer i vulosur dhe nenshkruar nga kompania dhe inxhinieri si dhe CV e nënshkruar nga vet inxhinieri, certifikata e sigurise ne pune e noterizuar, deshmite per pervojen referenca, Për stafin professional (inxhinierët) duhet te kene Diplomat-kopje e noterizuar, kontrata apo parakontrata në emer të projektit dhe CV-ja e nenshkruar nga vet inxhinieret .Te deshmohet me certifikatat e kerkuara, Per Inxh te emergjencave, CV, -Diploma - kopje e noterizuar ne gjashte mujorin e fundit, certifikata, -Kontrata e punes, apo parakontrata e per projektin ne fjale.

  3-Stafi teknik Lista e punëtoreve të OE duhet të jetë minimum 10 (dhjetë) punëtor me kontrata te punës aktive ku prej tyre duhet të jenë 1-(një) Teknik elektroinstalues 1 -(një) Teknik të elektronikes, I certifikuar per Auditimin e Energjise ne Ndricim Publik

  Deshmia:
  3.Të paraqitet Lista e Stafit teknik prej minimum 10 punëtor e nenshkruar dhe e vulosur nga OE. - Të paraqiten kontratat e punës ose parakontratat për këtë projekt. - Të prezantohen diplomat për stafin teknik. - Certifikata nga UP dhe ME per auditimin e energjise ne ndertesa Të deshmohen me çertifikata trajnimet për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë.

  4- Makineria dhe Mjetet e Punës të disponueshme
  - Një (1) Kamion me korpe

- Një (1) kamion me krane kiper 10m3.
- Dy (2) kamion kiper me kran me peshe bartese maksimum 4 ton
- Një (1) bager per germim te kanaleve max 6t;
- Dy ekskavator me peshe maksimum 3 ton
- Nje (1) miniekskavator me peshe maksimale 900 kg
- nje (1) kamionet dabellkabin me kran;
- kater (4) kamioneta dabell kabin kiper,
- Një (1) Kamionet kipper me peshe te gjithmbarshme max 6T
- Nje platforme ngritese gershere,
- Një (1) Kompesor ajri per thyrje max.1 ton
- Një (1) Motorrsharre
- Një motorr sharre per prerjen e betonit -asfalt.
- Pesë (5) Çekiq elektrik (TRAPAN), shpuese, rrotulluese dhe daltë
- Pesë (5) shkalle te aluminit
- Një (1) Pajisje matëse laserike
- Një (1) Skele
- Pompa per largimin e ujit nga kanalet mbi 1.5kw min 2cope.
-Trimera per pastrim tereni-kositje min 2cope
-Makine shtypese(vibropllak per ngjeshje te kanaleve) min 1cope
-Dy cilindra hekur hekur me gjemba me peshe maksimum 1.5 ton;
-Nje tractor me luge ngarkuese 4x4

Deshmia:
4.Lista e mjeteve të punës (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne origjinal te deshmuar me fatura ose libreza te regjistrimit valide, fature per blerjen, dud doganor në emër të kompanisë me të cilën konkuron ose grupit te operatoreve ekonomik te cilet konkurojne.ose munde te mirren me qera per kete projekt marreveshja te nenshkruar dhe te vulosur.

Duke ju referuar qellimit te kontrates e qe eshte:

Qëllimi i kontratës është qe te përcaktohen kushtet që rregullojnë kryerjen e punëve të riparimit/mirëmbajtjes si në vijim:
shëno përshkrimin e përgjithshëm të punëve dhe sasitë e vlerësuara të cilat MUND të blehen gjatë kohëzgjatjes së kontratës publike kornizë:
"DISLOKIMI I ELEMENTEVE TE LINJAVE TE TENSIONIT TE MESEM DHE TE ULET.(633-024-090-521)projekt 2vjeqar.
Jane 50 pozicione te ndryshme, per detaje referohu dosjes se tenderit dhe pershkrimit te cmimeve."

Ateher te gjitha *"Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kapaciteti teknik dhe professional"*, jane te jashteligjshme dhe jo proporcionale me natyren e projektit.

Duke ju referuar Aneks 1- Pershkrimi i cmimeve, ateher te gjitha punet qe do te kryhen jane pune ne rrjetin energjetik, respektivisht: shtylla, konzolla, izolator, kabllo te tensionit te ulet 0.6/1kV, kanal kabllor, gypa, elemente te tokezimit.
Ndersa menaxheri i projektit eshte kerkuar te jete i drejtimit **ELEKTRONIKE**:
"Menaxheri i kotratës duhet të jetë inxhinieri Inxhinier(master) elektrikes-drejtimi elektronike me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.I certifikuar si auditor I energjise ne ndertesa dhe ndricim public sipas standardit DIN EN 16247."

DHE TE JETE I CERTIFIKUAR PER SI AUDITOR I ENERGJISE NE NDERTESA DHE NDRICIME PUBLIKE SIPAS STANDARDIT DIN EN 16247

Pervec tjerash jane kerkuar edhe dy inxhinier te makinerise qe nuk nderlidhen aspak me natyren e puneve ne projekt, gje qe e deshmon ne skajshmeri nivelin e pa perputhshmerise se stafit te kerkuar me natyren e puneve ne projekt.

Gjithashtu ne stafin teknik eshte kerkuar:
3-Stafi teknik Lista e punëtoreve të OE duhet të jetë minimum 10 (dhjetë) punëtor me kontrata te punës aktive ku prej tyre duhet të jenë 1-(një) Teknik elektroinstalues ***1 -(një) Teknik të elektronikes, I certifikuar per Auditimin e Energjise ne Ndricim Publik***

Duke ju referuar Aneks 1- Pershkrimi i cmimeve, ateher te gjitha punet qe do te kryhen jane pune ne rrjetin energjetik, respektivisht: shtylla, konzolla, izolator, kabllo te tensionit te ulet 0.6/1kV, kanal kabllor, gypa, elemente te tokezimit.
Ateher asnje pune apo sherbim nuk nderlidhet me kerkesen specifike per stafin teknik: ***1 -(një) Teknik të elektronikes, I certifikuar per Auditimin e Energjise ne Ndricim Publik***, gje qe e deshmon ne skajshmeri nivelin e pa perputhshmerise se stafit te kerkuar me natyren e puneve ne projekt.

Ne anen tjeter, makineria e kerkuar:
4- Makineria dhe Mjetet e Punës të disponueshme
Eshte nje liste e makinerise qe nuk nderlidhet as per se afermi me natyren e puneve ne projekt, pervec se munde te nderlidhet me OE te caktur te cilit AK ju ka pergadite kete projekt.

Duke ju referuar:

1. ***Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik, respektivisht***

Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit
pika:

4.3 Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive.

b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paranë për Autoritetin Kontraktues.

c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.

d. Objektivitet/Integritet/Sinqeritet – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe

benefit të çfarëdo lloji nga Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin kompromitim të objektivitetit ose integritetit.

e. Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.

f. Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.

g. Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.

2. Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik, respektivisht

Neni 25 Kriteret e përzgjedhjes

25.6 Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

25.4 Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike. "Të arsyeshme dhe të mjaftueshme" do të nënkuptoj në lidhje me:

a. vlerën e parashikuar të kontratës, dhe

b. përdorim të drejtë të fondeve publike.

Me kete rast AK ka shkeluar te gjitha nenet e listuara ne hyrje te kerkeses per rishqyrtim.

Neve permes Aneks 5 KERKESE PER INFORMACIONE SHTESE te plotesuar nga dosja e tenderit me date: 05.11.2024 kemi kerkuar informacione shtese brenda afateve kohore per scarime te tenderit te percaktuar ne FDT, mirepo nuk kemi pranuar fare pergjegje nga AK.

Ndersa, konform ***Neni 53 te LPP, respektivisht Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik- Neni 24 Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore***, paragrafeve:

24.1 Një OE, mund të kërkojë, me shkrim, informata shtesë sqaruese për dokumentet e tenderit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik – vetëm nëpërmjet funksionit të dedikuar për kërkesa për sqarime.

24.3 AK do të përcaktoj afatet kohore në dosje të tenderit për pranimin e kërkesave për informacioneve shtesë ose sqarimeve. Afatet kohore duhet të jenë në pajtueshmëri me Nenin 53 të LPP.

24.4 AK do të shqyrtoj menjëherë kërkesën sipas paragrafit 24.3 të kësaj rregullore dhe do të konstatoj nëse informata shtesë ose sqarimi i kërkuar është i nevojshëm apo jo.

a) Nëse jo AK do të informoj menjëherë, përmes platformës, OE në fjalë për mohim.

b) *Nëse po AK do të ofrojë informatat shtesë menjëherë, përmes platformës, por nuk do të bëjë të ditur burimin e kërkesës së tillë.*

Ateher, AK duke mos u pergjigjur ne kerkesen per informacione shtese ka vepruar ndesh me ***Neni 53 te LPP, respektivisht Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik- Neni 24 Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore***

Ndersa konform: ***RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK Neni 60 Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore,*** neve kemi ngarkuar ne platformen e-prokurimi kerkesen per rishqyrtim me date: 14.11.2024, mirepo deri me date: 20.11.2024 nuk kemi pranuar pergjegje nga AK apo ndonje njoftim eventual per afat shtese ne kthim te pergjegjes nga AK.

Ateher, AK duke mos u pergjigjur ne kerkesen per rishqyrtim ka vepruar ndesh me ***Neni 60 Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore, respektivisht Neni 63 Vendimi i Autoritetit Kontraktues nga RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK*** *Pika: 63.2. Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit. Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejte që të parashtroj një ankese pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0).*

Njëkohësisht AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **Risamont SH.P.K.**
TE VAZHDOHET AFATI I DOREZIMIT TE OFERTAVE
TE HIQEN KRITERET DISKRIMINUESE DHE JO PROPORCIONALE ME NATYREN E PROJEKTIT, ndërsa rivlerësimi të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave proporcionale ne raport me natyren e projektit duke respektuar parimet e barazise dhe jo-diskriminimit, përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demtet materiale do te llogariten ne fazat vijuese

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*